# DËSHMI ARKIVI

**A-453493**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | 'Gjykatë politike'/ Bushati: Rama kur mori helikopterin e dinte se po i bëhej koncension Rusisë dhe Serbi së |
| ADRESA | `https://piranjat.al/politike/gjykate-politike-bushati-rama-kur-mori-helikopterin-e-dinte-se-po-i-beh-i104739` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 20:20:55 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 20:07:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2a7f64d482dd85900940dd7b67b2a2e01e3d4336814ef9cedea5f25d7cfaef7f` |
| TEKSTI | `0333dc8717e21b1bfbc9cd98f19dc4e2560cea39aea9567c69f2d09bc6abd5a0` |
| PAMJA | `d3dfd92a2c4162511b586bed81f1d7a38adc110c87ec9771ee24511f25d31e0d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `928795d383f4744e1b9c8dd3abd910ed0a19e174aff075676492fa793c77bbd6` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `3b121f0f38f9983afad61fe399871208f196860b9a8965bfd896e6b91a545c4e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/928795d383f4744e1b9c8dd3abd910ed0a19e174aff075676492fa793c77bbd6`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Flash: Zbardhet dinamika rrugor në rrugën Poseidonos ■ është kaq strategjike Jemenit, në Gadishullin Arabik, dhe ■ 1: Lironi çunat nr 1. Pasi në këtë komisariat mb ■ u godit banda e e cila e kishte qendrën në Katalonia ■ represioni nuk na kundër Ramës. Akt... ■

POLITIKE

# ‘Gjykatë politike’/ Bushati: Rama kur mori helikopterin e dinte se po i bëhej koncension Rusisë dhe Serbisë

Piranjat Përditësimi i fundit 17 Shtator 2026, 22:07



Analisti Andi Bushati ka komentuar ashpër procesin ndaj ish-krerëve të UÇK-së dhe vendimin e Gjykatës Speciale në Hagë. Bushati e cilësoi gjykatën si të instrumentalizuar politikisht dhe ngriti pikëpyetje mbi mënyrën se si ajo u krijua dhe funksionoi.

Bushati u ndal edhe te roli i politikës shqiptare, duke përmendur Edi Ramën dhe qëndrimet e kohës ndaj krijimit të kësaj gjykate. Sipas tij, palët shqiptare e dinin se ky proces do të sillte pasoja, ndërsa e lidhi këtë zhvillim me atë që e cilësoi si koncesion ndaj interesave të Serbisë dhe Rusisë.

Debati në studio:

Bushati: Atëherë, pavarësisht se shoqëria shqiptare kishte nevojë për këtë lloj katarsisi edhe ndaj heronjve të vet çlirimtarë. Unë kam besuar se ka njerëz që kanë thënë, jo mo nuk duhet luftë, kush ka ikur i keqi e njohim e thatë, le të ikim ta mbyllim këtë kapitull. Unë mendoj që këtë gjë ne duhet ta bënim. A ishte kjo gjykatë gjëja që e bëri? Këtu unë jam kundra. Gjykatë e instrumentalizuar, gjykatë politike, gjykatë që u tregua nga mënyra si e mori Hashim Thaçin ditën që po shkonte për në Shtëpi të Bardhë e deri dje që u dha dënimi, një instrument politik. Por tani, unë besoj që këtu të biem të gjithë dakord që ky ishte instrument politik. Dhe nuk duhet të gjejmë segmente që, ja dhe ky për këtë është politik, ja çfarë tha dhe ky këtu, ja çfarë tha... Puna është të kuptojmë pse arritëm te ky instrument politik. Sepse kjo është një gjykatë që e kanë krijuar shqiptarët. Ata dje i dënuan komandantët në emër të popullit të Kosovës, e ka votuar parlamenti i Kosovës. Dhe këtu unë tund kokën ndaj Beratit. Se askush sot nuk mund të lajë duart dhe të thotë se nuk e dinim.

Buzhala: A se s'më dëgjova që përmende ligjin?

Bushati: Jo jo ligjin, ligjin, shkurt...

Buzhala: Një karrige... nuk mundesh me më thënë, nuk mundesh me i la duart kur ligji është ndryshe e akuzat ndryshe.

Bushati: Një sekondë, një sekondë. Ligji është i shkruar ashtu siç thua ti, ok, por që nga Hashim Thaçi i pari, që nga ne gazetarët, që nga Edi Rama që mori helikopterin, të gjithë e dinim që kishte arritur një pikë që duhet t'i bëhej koncesion Serbisë dhe Rusisë. Pra, vetë Hashim Thaçi në qoftë se e mbani mend, ajo beteja që ka qenë, pati tentativë në parlament për ta përmbysur gjykatën, se e dinte se çfarë e priste. Vetëvendosja, pak e parëndësishme në atë kohë, nuk është se nuk i dha argumentat. Fjalimi i Hashim Thaçit në parlament, pavarësisht se thoshte duhet ta votojmë, po ta dëgjosh të gjithë tekstin, teksti është që sa dëm i bën kjo gjë Kosovës.

Pra të gjithë ishin të bindur, që pavarësisht si po shkruhej ligji dhe si justifikohej me Dick Martyn, këtu po i bëhej një koncesion... ne ja bënim amerikanëve dhe evropianëve, po amerikanët dhe evropianët po ja bënin Serbisë dhe Rusisë. Prandaj kësaj gjykate i duhej thënë që në gjenezë, jo. Atëherë, po po t'i thoje jo, mund të thotë dikush, bie kjo teoria jote që ka nevojë për katarsis... shoqëria duhet ta bëjë katarsisin.

Unë them jo, se pikërisht ajo që ndodhi sot, dënimi i padrejtë dhe procesi surrogato ndaj atyre njerëzve, ka mbyllur njëherë e mirë kapitullin e një hapjes së debatit për krimet e shqiptarëve me shqiptarët, jo krimet me serbët, kjo mbyllet, askush nuk merr sot më guximin, thotë po krimet e shqiptarëve... shih sa u paguan ata të gjithë e të tjerë. Kjo është e keqja e parë. Dhe e keqja e dytë mendoj unë, për të cilën duhet ta vrasim mendjen shumë, është servilizmi dhe bythëlëpirja jonë ndaj ndërkombëtarëve. Berati e thotë, na thanë ambasadorët. E punë e madhe! Ambasadori mundet të bëjë trafik për t'i bërë, për të marrë një koncesion tjetër nga Rusia, Serbia, nuk është argument!

## Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 17 Shtator22:04

**“Biden e dinte, por unë zgjodha gjykatën”, Berisha zbulon si u rikthye në SHBA**

Pas disa vitesh jashtë Shteteve të Bashkuara, Sali Berisha ka rrëfyer në “Opinion” përpjekjet që, sipas tij, çu...

POLITIKE 17 Shtator21:45

**“I djeg kësula”, Berisha vë Ramën në qendër të debatit për UÇK-në**

Në nisje të emisionit të sotëm të “Opinion”, kryedemokrati Sali Berisha u ndal te çështja më e diskutuar e...

POLITIKE 17 Shtator21:40

**Pagat e magjistratëve/ Bardhi: Drafti i PS, “puç kushtetues”! Shkel vendimin e Kushtetueses, vota jonë kundër**

Kreu i grupit parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi, kundërshtoi në Kuvend projektligjin e PS-së për pagat e magjistratëve, du...

POLITIKE 17 Shtator20:42

**Vijojnë dëgjesat, Divjaka kundër Territoriales: Nuk pranojmë shkrirjen e bashkisë**

Dëgjesa e radhës publike në kuadër të reformës administrative për Komisionin e Këshillit Bashkiak Divjakë ësht...

POLITIKE 17 Shtator20:35

**110 ditë revoltë, protestuesit marshojnë drejt komisariatit 1: Lironi çunat**

Kanë përfunduar fjalimet te Kryeministria. Protestuesit kanë nisur marshimin drejt komisariatit nr 1. Pasi në këtë komisariat mb...

POLITIKE 17 Shtator20:24

**Dhuna policore, aktivisti: Të qëndrojmë bashkë, nga sot më shumë vepra dhe më pak fjalë!**

Aktivisti Edison Lika mbajti fjalën e tij në protestën e 110-të para kryeministrisë. Ai u shpreh se kjo protestë ka qenë paq&...

POLITIKE 17 Shtator20:03

**Korreshi ironizon qeverinë: Fshati akoma te parmenda, ju na tregoni inteligjencën artificiale**

Deputeti i Partisë Demokratike, Saimir Korreshi, ka ironizuar Qeverinë, në lidhje me përhapjen e inteligjencës artificiale në inst...

POLITIKE 17 Shtator20:03

**Bardhi denoncon: Kompania që u kap me 41 kg kokainë, përfitoi nga Qeveria 1 milion euro nga fondet e IPARD**

Kreu i Grupit Parlamentar të PD, Gazment Bardhi ka denoncuar një skandal gjatë fjalës së tij ne seancën e Kuvendit. Sipas tij, ko...

POLITIKE 17 Shtator19:44

**Protesta e 110 kundër qeverisë/ Aktivistja: Dhuna dhe represioni nuk na tremb!**

“Rama në burg", “poshtë narkoshteti”, janë thirrjet e qytetarëve në protestën e 110 kundër Ramës. Akt...

POLITIKE 17 Shtator19:41

**“Të plasi trapi…”/ Çfarë zbulojnë email-et e Ballukut për vilën në Green Coast**

Vendimi i GJKKO-së për sekuestrimin e vilës në kompleksin “Green Coast” përmban një numër komunikimesh dhe emaile...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

**Sarandë, tre persona plagosen me thikë pranë sh...**

Një ngjarje e rëndë është shënuar mbrëmjen e sotme në Sarandë, ku tre persona kanë mbetur të plagosur me ...

BOTA 16 Shtator

**VIDEO- Dy aksidente me pesë viktima/ Prezantues...**

Pesë persona kanë humbur jetën në një aksident të dyfishtë tragjik në Los Anxhelos, ndërsa një gazetare televi...

POLITIKE 17 Shtator

[Tensionet te ministria e Brendshme, shoqërohet ...]

Vijojnë tensionet para Ministrisë së Brendshme. Një grup protestuesit kanë hedhur letra higjienike në drejtim të policis&e...

INVESTIGIME 17 Shtator17:59

[Tensionet te Kuvendi, shoqërohen në polici të paktën 25 protestues]

Të paktën 25 persona janë shoqëruar nga policia pas tensioneve të regjistruara gjatë protestës së zhvilluar sot pran&eum...

## video



## E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV





**E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**



**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**






Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.